



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1089 / Prot
13

Tiranë, më 09 / 10 / 2020

VENDIM

Nr. 43 , datë 09 . 10 . 2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____ ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") Formularin e Ankesës nr. 1089 Prot., datë 14.9.2020, me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*", kundër Autoritetit Publik "Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore" (në vijim "Autoriteti Publik").

Ankuesi nëpërmjet *e-mailit* të datës 20.07.2020, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni si vijon:

- *Kopje të raportit të opionencës teknike për hidrocentralet si më poshtë:*

1. HEC Marinaj/ "Energotek" (250 kW);
2. HEC Borie Lurë I/ "Ageta Sh.p.k dhe BAJRAMI Sh.p.k" (1800 kW);
3. HEC Shulleri/ "Thoreneks Sh.p.k"(1400 kW);
4. HEC Niçel/ "Jova Company Sh.p.k" (1002 kW);
5. HEC Kastrioti I/ "Afrimi K Sh.p.k" (1990 kW);
6. HEC Humelicë/ "Gjeokonsult & CO Sh.p.k dhe Engineering System Sh.p.k" (1994 kW)
7. HEC Bushi dhe Bushi I (përroi Guri i Topit dhe përroi i Perlikajt, Mirditë)/"Kthella Sh.p.k" (191kW dhe 228 kW);
8. HEC Gomsiqe e Epërme (Përroi i Gomsiqes dhe Përroi i Kcirës)/"Sima Com Sh.p.k dhe ROLAND Sh.p.k" (1980 kW);
9. HEC Rukaj (Rrjedha e sipërme e Përroit të Gomsiqes)/ "Sima Com Sh.p.k dhe ROLAND Sh.p.k" (1824 kW).

Autoriteti Publik, me e-mailin e datës 04.08.2020, ka vënë në dispozicion të kërkuarit pjesërisht informacionin e kërkuar, duke mos argumentuar refuzimin për dhënien e plotë të tij.

Me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në këtë këndvështrim, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “Ligji nr.119/2014”), nëpërmjet shkresës nr. 1089/1Prot., datë 15.09.2020, drejtuar Autoritetit Publik, Zyra e Komisionerit kërkoi parashtrime në lidhje me pretendimin e ankuesit për refuzim të dhënies së plotë të informacionit.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, Autoritetit Publik i është bërë me dije se sipas nenit 12, 14 dhe 16 të ligjit, detyrohet të informojë ankuesin lidhur me kërkesën e tij, si dhe të vlerësojë vënien në dispozicion të informacionit duke mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014”, në të cilën parashikohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim....”*

Në vijim, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje, duke vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, të anonimizuar.

Nëpërmjet e-mailit të datës 29.09.2020, ankuesi ka vijuar ankimin me pretendimin se informacioni nuk është i plotë, si dhe ka parashtruar se Autoriteti Publik nuk ka cituar bazën ligjore mbi të cilën është bërë kufizimi i dhënies së informacionit.

Komisioneri vlerëson se për çështjen objekt shqyrtimi duhen mbajtur në konsideratë parashikimet sipas ligjit material dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit.

Gjithashtu, vlerësohet se përderisa Autoriteti Publik është prodhues dhe mbajtës i informacionit të kërkuar, bazuar në nenin 1 pika 1 e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin citohet se: *“Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike”*, rrjedhimisht ka detyrimin ligjor për ta vënë në dispozicion të kërkuarit.

Bazuar në nenin 4, pika 3 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575 datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik

privat” i ndryshuar, përcaktohet ndër të tjera se: *“Oponenca teknike kryhet nga struktura përgjegjëse shtetërore”,* fakt i cili bën që këto struktura si dhe informacioni i prodhuar prej tyre të jenë objekt i Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*.

Komisioneri vlerëson se bazuar në nenin 17 pika 6 e Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, sipas të cilit *“...Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”,* Autoriteti Publik duhet të kishte kufizuar pjesët e raportit të oponencës teknike, të cilat i nënshtrohen kufizimeve, duke parashtruar argumentet ligjorë mbi bazën e së cilave është bërë kufizimi. Ky argument, është konsoliduar edhe me Vendimin nr. 1660 datë 22.07.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për një çështje me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt, rast i sjellë për analogji edhe nga ankuesi. Në këtë vendim, ndër të tjera është cituar se...” *AKBN-ja duhet të tregonte qartë pjesët e dokumentacionit të raportit të oponencës teknike që janë refuzuar”*.

Ligji nr.119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* në pikën 2 të nenit 17 të tij, parashikon detyrimin e Autoritetit Publik, që në çdo rast duhet të respektojë parimin e proporcionalitetit, duke vlerësuar nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Në përputhje qëllimin e Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, sipas të cilit publikut duhet ti garantohet njohja me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe për ti shërbyer nxitjes së integritetit, të transparencës dhe të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, Komisioneri, vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të ankuesit, dokumentacionin sipas kërkesës së datës 20.07.2020, duke mbajtur në konsideratë pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*.

Ndërkohë në pikën 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2 të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

E drejta e informimit, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të

Drejta të Njeriut (KEDNJ). Organet e administratës publike janë të detyruara t'i nënshtrohen parashikimeve kushtetuese dhe të konventës por dhe atyre të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", me qëllim garantimin efektiv të parimit të transparencës.

Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative' i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 1089 Prot., datë 14.09.2020, të z. _____, kundër Autoritetit Publik "Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (*Raportin e Oponencës Teknike sipas objektit të kërkesës*), brenda datës 16.10.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u shpall sot në datë 09.10.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

